



PSH.nr.930/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Loshi-Design” -Gurakoc, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “ADI TE CONSTRUCTION” Shpk – ISTOG, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “FASADIMI I NDERTESAVE TE BANIMIT NE BASHKPRONESI TE PARALUFTES” me nr. prokurimi “633-20-5698-5-2-1” iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK ISTOG, më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Loshi-Design” – Gurakoc, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “FASADIMI I NDERTESAVE TE BANIMIT NE BASHKPRONESI TE PARALUFTES” me nr. prokurimi “633-20-5698-5-2-1” iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK ISTOG.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “FASADIMI I NDERTESAVE TE BANIMIT NE BASHKPRONESI TE PARALUFTES” me nr. prokurimi “633-20-5698-5-2-1” iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK ISTOG, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik “Loshi-Design” – Gurakoc, aprovohet pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “Loshi-Design” – Gurakoc, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 13.11.2020 me nr. 930/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “FASADIMI I NDERTESAVE TE BANIMIT NE BASHKPRONESI TE PARALUFTES” me nr. prokurimi “633-20-5698-5-2-1” iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK ISTOG, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 59, 60, 64, dhe 69 i Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 24.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e FDT-së përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale neni 9.1 & 9.2 tek kapaciteti teknik dhe profesional ku si kërkesë ka qenë “Operatori Ekonomik duhet te ofrojë dëshmi se ka ose mund të angazhoj staf teknik te mjaftueshem dhe atë min. 10 punëtorë” ndërsa si dëshmi dokumentare duhet të ketë “Listën e punëtorëve nga ATK, së paku për 3 muajt e fundit para publikimit

të njoftimit për kontratë; për stafin e angazhuar për këtë projekt i cili nuk është në marrëdhënie pune me OE ofertues, si dëshmi të paraqiten lista e punetoreve dhe kontratat për projektin në fjalë” pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një listë të pagave nga ATK që dyshohet që ka pasur ndërhyrje nga ky i fundit, Eksperti pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe dokumentacionit të tenderit e gjen pretendimin e lartpërmendur si të pabazuar. Arsyetimi është si në vijim:

- Lista e pagave të ATK-së e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë përfshin gjithsej 11 punëtorë të cilët janë konfirmuar me kontrata ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit. Eksperti ka provuar të kontaktojë me ATK-në për të verifikuar validitetin e listës së dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë (shih faktin 5). Në ndërkohë, përgjatë komunikimit me Autoritetin Kontraktues për të konfirmuar nëse komisioni i vlerësimit ka verifikuar një dokument të tillë, AK ka konfirmuar me email (shih faktin 6) që lista e ATK-së e lëshuar me datë 04.05.2020 në kohën e ofertimit ka qenë valide pasi që dokumentohen punëtorët e regjistruar që nga muaji maj 2020 në listën e pagave të ATK-së të bashkëngjitur në email.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se menaxherin e projektit të cilin e ka prezantuar nuk plotëson kërkesën e FDT-së e cila ka qenë: “Menaxheri i projektit të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë Konstruktiv, me së paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku tri (3) projekte te natyrës se njëjte (fasadim te objekteve)” me dëshmi dokumentare të kërkuar “për menaxher të projektit; CV, diploma e skanuar nga origjinali, vendimi për caktim te menaxherit, kontrata e punës ose parakontrata për projektin ne fjale dhe letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara” pasi që në ofertë ka prezantuar noterizimin e diplomës të datës 30.08.2017, noterizim ky jo i vlefshëm për faktin që është më i vjetër se 6 muaj. Një pretendim të tillë Eksperti Shqyrtues e gjen si të pabazuar me arsyetimin si në vijim:

- Në ligjin për noterinë me nr. 06/L-010, gjegjësisht neni 47 - Vërtetimi i kopjeve të dokumenteve origjinale, Noteri vërteton vetëm kopjet e dokumenteve origjinale të përgatitura në zyrën e noterit. Noteri mund të vërtetojë gjithashtu kopjet e dokumenteve origjinale të sjellura nga palët për vërtetim, me kusht që kopja e dokumentit të jetë bërë në zyrën e noterit. Një dispozitë e tillë ligjore nuk përcakton afat kohor për validitetin e vërtetimit të kopjeve të dokumenteve origjinale. Do të thotë, përderisa Akti noterial nuk ka kufizime kohore të shënuara decitivisht në dokumentin përkatës, një vlefshmëri e tillë prej vetëm 6 muajsh nga data e noterimit përmendur nga OE ankues nuk vlen.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar asnjë kontratë referencë konform kërkesave të FDT-së duke marrë parasysh faktin që një kërkesë e tillë ka qenë “Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë (fasadim te objekteve) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.”, Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të listës së kontratave dhe dëshmive dokumentare të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë, gjen pretendimin ankimor si pjesërisht të bazuar. Arsyetimi vijon si më tutje:

- Për faktin që kërkesa e shënuar nga AK në FDT dhe Njoftim për Kontratë ka qenë e specifikuar vetëm në kontrata të fasadim të objekteve, Eksperti vlerëson që fushëveprimi i kontratave të dorëzuara nuk përkon në tërësi me natyrën e aktivitetit të prokurimit (shih faktin me nr. 7). Sidoqoftë, konform dispozitave ligjore në fuqi të shënuara edhe në RRUOPP, mbetet nën diskrecion të Autoritetit Kontraktues që ky i fundit mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së.
- Për faktin që lista e kontratave përfshin gjithsej 17 kontrata të cilat janë të shënuara nga OE i rekomanduar për kontratë si referencë e që kanë natyrë të ngjashme apo të njëjtë me aktivitetin e tanishëm të prokurimit, mbetet nën përgjegjësinë juridike të Autoritetit Kontraktues që të konstatojë nëse përmbajtja (punët e kryera në këtë rast) e tyre përkon me fushëveprimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “FASADIMI I NDERTESAVE TE BANIMIT NE BASHKPRONESI TE PARALUFTES” me nr. të prokurimit: “633-20-5698-5-2-1”, *aktivitet ky i iniciuar nga AK: Komuna e Istogut, të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.*

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, Nuk ka përgjigje

Operatori Ekonomik, me date 25.11.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Loshi-Design” -Gurakoc se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e FDT-së përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale neni 9.1 & 9.2 tek kapaciteti teknik dhe profesional ku si kërkesë ka qenë “Operatori Ekonomik duhet te ofrojë dëshmi se ka ose mund të angazhoj staf teknik te mjaftueshëm dhe atë min. 10 punëtorë” ndërsa si dëshmi dokumentare duhet të ketë “Listën e punëtorëve nga ATK, së paku për 3 muajt e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë; për stafin e angazhuar për këtë projekt i cili nuk është në marrëdhënie pune me OE ofertues, si dëshmi të paraqiten lista e punëtorëve dhe kontratat për projektin në fjalë” pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një listë të pagave nga ATK që dyshohet që ka pasur ndërhyrje nga ky i fundit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendim i OE ankues është i pa bazuar për faktin se lista e pagave të ATK-së e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë përfshin gjithsej 11 punëtorë të cilët janë konfirmuar me kontrata ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ka provuar të kontaktojë me ATK-në për të verifikuar validitetin e listës së dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë (shih faktin 5). Në ndërkohë, përgjatë komunikimit me Autoritetin Kontraktues për të konfirmuar nëse komisioni i vlerësimit ka verifikuar një dokument të tillë, AK ka konfirmuar me email (shih faktin 6) që lista e ATK-së e lëshuar me datë 04.05.2020 në kohën e ofertimit ka qenë valide pasi që dokumentohen punëtorët e regjistruar që nga muaji maj 2020 në listën e pagave të ATK-së të bashkëngjitur në email.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Loshi-Design” -Gurakoc se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se menaxherin e projektit të cilin e ka prezantuar nuk plotëson kërkesën e FDT-së e cila ka qenë: “Menaxheri i projektit të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë Konstruktiv, me së paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku

tri (3) projekte te natyrës se njëjte (fasadim te objekteve)” me dëshmi dokumentare të kërkuar “për menaxher të projektit; CV, diploma e skanuar nga origjinali, vendimi për caktim të menaxherit, kontrata e punës ose parakontrata për projektin në fjale dhe letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara” pasi që në ofertë ka prezantuar noterizimin e diplomës të datës 30.08.2017, noterizim ky jo i vlefshëm për faktin që është më i vjetër se 6 muaj. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendim i OE ankues është i pa bazuar për faktin se në ligjin për noterinë me nr. 06/L-010, gjegjësisht neni 47 - Vërtetimi i kopjeve të dokumenteve origjinale, Noteri vërteton vetëm kopjet e dokumenteve origjinale të përgatitura në zyrën e noterit. Noteri mund të vërtetojë gjithashtu kopjet e dokumenteve origjinale të sjellura nga palët për vërtetim, me kusht që kopja e dokumentit të jetë bërë në zyrën e noterit. Një dispozitë e tillë ligjore nuk përcakton afat kohor për validitetin e vërtetimit të kopjeve të dokumenteve origjinale. Do të thotë, përderisa Akti noterial nuk ka kufizime kohore të shënuara decitivisht në dokumentin përkatës, një vlefshmëri e tillë prej vetëm 6 muajsh nga data e noterimit përmendur nga OE ankues nuk vlen.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Loshi-Design” -Gurakoc se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar asnjë kontratë referencë konform kërkesave të FDT-së duke marrë parasysh faktin që një kërkesë e tillë ka qenë “Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë (fasadim te objekteve) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.” Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të listës së kontratave dhe dëshmive dokumentare të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë, pretendimin ankimor i OE ankues në këtë pik është pjesërisht i bazuar për faktin se kërkesa e shënuar nga AK në FDT dhe Njoftim për Kontratë ka qenë e specifikuar vetëm në kontrata të fasadim të objekteve, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson që fushëveprimi i kontratave të dorëzuara nuk përkon në tërësi me natyrën e aktivitetit të prokurimit (shih faktin me nr. 7). Sidoqoftë, konform dispozitave ligjore në fuqi të shënuara edhe në RRUOPP, mbetet nën diskrecion të Autoritetit Kontraktues që ky i fundit mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së. Për faktin që lista e kontratave përfshin gjithsej 17 kontrata të cilat janë të shënuara nga OE i rekomanduar për kontratë si referencë e që kanë natyrë të ngjashme apo të njëjtë me aktivitetin e tanishëm të prokurimit, mbetet nën përgjegjësinë juridike të Autoritetit Kontraktues që të konstatojë nëse përmbajtja (punët e kryera në këtë rast) e tyre përkon me fushëveprimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues në bazë të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK nuk ka bërë vlerësim të drejtë të ofertave në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK ISTOG";
- 1x1 OE "Loshi Design" – Gurakoc;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.